

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING	
Njësia Org. Org. Jedinice Org. Unit	17-01
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	2348-2/13
Nr i faqeve Br. Stranica No. Pages	03
Data : Datum : Date :	09/07/2013
Prishtinë / a	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**  
**Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja**  
**Ministry of Environment and Spatial Planning**

Nr. 20 /2013  
 Datë: 09/07/2013

Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në mbështetje të nenit 145 (parag. 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010) si dhe duke u bazuar në nenin 8 (nënparagrafi 1.4) dhe Shtojcën 13 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), Rregullores Nr.07/2011 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr.02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dhe në pajtim me nenin 13 (parag.3) të Udhëzimit Administrativ Nr. 11/2013 për përcaktimin e kërkesave teknike dhe kërkesave tjera për qeset e plastikës nxjerr:

## V E N D I M

### Neni 1 Qëllimi

1. Me këtë vendim Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përcakton procedurën e formimit të Komisionit për lëshimin e Lejes për prodhim, import dhe eksport të qeseve të plastikës pa shtesë të aditivit për biodegradimin e qeseve në formë të thasëve prej plastike për nevojat e prodhuesve të mallrave industriale ( në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).
2. Komisioni do të shqyrtoj kërkesat e paraqitura në Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për lëshimin e Lejes për prodhuesin, importuesin dhe eksportuesin e qeseve pa aditiv për nevojat e prodhuesve të mallrave industriale.
3. Dokumetacioni i nevojshëm për leje:
  - 3.1. kërkesa nga prodhuesi, importuesi ose eksportuesi e cilat duhet përmbaj shënimet për: llojin e plastikës, sasinë që do të prodhoj, eksportojoj apo importoj dhe qëllimin e përdorimit;
  - 3.2. çertifikata e regjistrimit dhe informata mbi biznesin për veprimtaritë e regjistruara;
  - 3.3. çertifikata e numrit fiskal;

3.4. çertifikata për import dhe eksport të mallrave;

3.5. kontratën në mes importuesit të qeseve pa aditiv dhe prodhuesit të mallrave industriale (në rast se importuesi i qeseve nuk është prodhuesi i mallit).

## **Neni 2**

### **Proceduara për formimin e Komisionit**

1. Komisioni për vlerësimin dhe lëshimin e Lejes për prodhuesin, importuesin dhe eksportuesin e qeseve pa aditiv për nevojat e prodhuesve të mallrave industriale, propozohet nga Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë duke përfshirë edhe Kryetarin. Përbërja e komisionit të propozuar për Leje eksporti, importi ose prodhimit aprovohet nga Drejtori i Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe miratohet nga Sekretari i Përgjithshëm i MMPH-së për çdo kërkesë nga palët.
2. Komisioni për Leje ushtron veprimtarinë në përputhje me dispozitat e këtij Vendimi dhe akteve tjera ligjore në fuqi që përcaktojnë kushtet dhe kriteret në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

## **Neni 3**

### **Marrja e vendimit**

1. Komisioni për lëshimin e Lejes shqyrton dokumentacionin që ka të bëjë me lëshimin e Lejes dhe jep rekomandim jo më vonë se 45 ditë nga dita e dorëzimit të kërkesës për leje.
2. Komisioni për Leje rekomandon për lëshimin ose mos lëshimin e Lejes në bazë të vlerësimit të dokumentacionit.
3. Procesverbali i Komisionit për Leje nënshkruhet nga Kryetari dhe anëtarët e Komisionit që kanë qenë pjesëmarrës në takim dhe në procesin e shqyrtimit të kërkesës.
4. Në bazë të procesverbalit të Komisionit hartohet vendimi për Leje dhe nënshkruhet nga Sekretari i Përgjithshëm i MMPH, më së largu, në afat prej 60 ditë pune nga dita e dorëzimit të kërkesës.

## **Neni 4**

### **Vlefshmëria dhe ndërprerja e vlefshmërisë së Lejes**

1. Vlefshmëria e Lejes mund të ndërpritet nga Ministria në rastet si në vijim:
  - 4.1.1. nëse nga personi nuk janë përmbushur plotësisht kushtet sipas të cilave është lëshuar Leja;
  - 4.1.3. nëse vërtetohet se është dhënë informatë e pavërtetë për marrjen e Lejes;
  - 4.1.4. me kërkesën e arsyeshme të doganës;
  - 4.1.5. nëse leja keqpërdoret.

2. Ndërprerja e Lejes mund të bëhet edhe me kërkesë të personit që posedon Lejen.
3. Ndërprerja e Lejes bëhet me vendim të Ministrisë, dhe me këtë rast poseduesi i Lejes do të informohet për ndërprerjen e Lejes.
4. Leja do të vlejë për sasinë e kërkuar nga aplikuesi dhe në afat kohor prej një viti nga dita e lëshimit të saj.

**Neni 5**  
**Zbatimi dhe hyrja në fuqi**

1. Mbikqyrjen dhe zbatimin e Lejes e bënë Dogana e Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Vendimi i dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Arkivit të MMPH-së;
- DMM-së
- Kabinetit të Ministrit.
- Dogana e Kosovës.

**Dardan Gashi**

**Ministër i MMPH-së**

